



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNEA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUŠTRIN	
GI Nr. / Br	47/20
No. l fq. / Br. st	- 1 -
Data / Datum	27.02.2020



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 shkurt 2020**, merr këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR FËMIJËT E PORSALINDUR

1. Me këtë vendim aprovet ndihma financiare për secilin fëmijë të porsalindur, në vlerë prej 120.00 € (njëqind e njëzet euro), prindërit e të cilëve janë banorë të përhershëm të Komunës së Vushtrrisë.
2. Mjetet financiare në shumën e cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi sigurohen nga buxheti i komunës kategoria subvencione dhe transfere, të cilat do të transferohen në xhirrollogarinë e prindërve (nënës ose babait) të fëmijëve të porsalindur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë tjera kompetente të Komunës së Vushtrrisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISE OPSTINA VUSHTRIN	
01 Nr. / Br	48/20
Nr. i fq. / Br. sh	- 1 -
Datim / Datum	27.02.2020
KRYETARI I KOMUNES	



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 41, paragrafi 2, pika “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 shkurt 2020**, merr këtë:

VENDIM PËR APROVIMIN E INICIATIVËS PËR NDRYSHIM TË RREGULLORES

1. Me këtë vendim aprovet iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (KKV) nr.01/2020 për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës të Veprimtarive Afariste - Bizneseve në Komunën e Vushtrisë me numër të protokollit 01 Nr.15/20 e datës 30.1.2020.
2. Obligohet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, që në bashkëpunim me Drejtorinë për Inspektime t'i zhvillojnë procedurat e nevojshme ligjore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores së lartcekur, duke i marrë për bazë petitionet e parashtruara nga ana e bizneseve të qytetit të Vushtrisë, të cilat janë shqyrtuar në Kuvendin e komunës në mbledhjen e muajit shkurt.
3. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Inspektime që draftin e kësaj rregulloreje ta sjellin në kuvend në mbledhjen e muajit mars.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Inspektime.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.



Nasuf Aliu
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUSHTRIN	
01 Nr. / Br	49/20
Nr. / Br. et	-1-
Data / Datum	27.02.2020
VUSHTRIN - VUSHTRIN	



Kuvendi i Komunës-Vushtrim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 34 të Ligjit Nr.02/L-53 për Gjuetinë, nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr.06/2009 për Dhënie në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta dhe nenin 40, paragrafi 2, pika "k" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 27 shkurt 2020 mori këtë:

VENDIM
PËR KORRIGJIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRISË ME NR.01. 84/18, I DATËS 29.3.2018

1.Me këtë vendim korrigjohet pika 1.1 dhe 1.2 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë me numër të protokollit Nr.01. 84/18 i datës 29.3.2018 për dhënien në shfrytëzim me kompensim të vendgjuetive të përbashkëta, ashtu që të bëhet korrigjimi i sipërfaqes si në vijim:

1.1. Shalë.....194.85,00 ha
(Njëqind e nëntëdhjetë e katër hektarë e tetëdhjetë e pesë ari)

1.2. Çyqavica.....128.78,67 ha
(Njëqind e njëzet e tetë hektarë e shtatëdhjetë e tetë ari e gjashtëdhjetë e shtatë metra katror)

2. Pjesët tjera të vendimit me numër të protokollit Nr.01. 84/18 i datës 29.3.2018 mbesin të pandryshuara.

3. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë: harta për Zonën e Shalës dhe Zonën e Çyqavicës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Prokurimit dhe Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

